

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga Alba Kepi - Italia drejt zgjedhjeve të 2027-ës, alarmi për përdorimin e IA-së në fushatën elektorale
ADRESA	https://www.syri.net/bote/919713/italia-drejt-zgjedhjeve-te-2027-es-alarmi-per-perdorimi-n-e-ia-se-ne-fushaten-elektorale/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:50:00 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 12:26:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b4b46e54840928f3fc95d9011c8738814fca0fae53d7d3b3e3b8d00a2473c703
TEKSTI	59697333d7fe655d92add7272d40ff689abe710c56ca41dfb9e7ade7ae59f158
PAMJA	c7a91b72122cf97963bc1f6a6827c20b9a4bdfead2cb3af9ec998313c6058861

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7d1f70198d81b72b4066cc2146114240ea7c1d506ec7384475b72e8a5e813518
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7d1f70198d81b72b4066cc2146114240ea7c1d506ec7384475b72e8a5e813518>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



ÇIM PEÇA
'Nuk e dija, nuk mjafton më'



FATMIR MEDIU
Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



më të lexuarat

Rodos: Makth i dyfishtë për 44-vjeçaren polake nga 28-vjeçari shqiptar: Ai i mori 15,000 euro dhe kur ajo ia kërkoi...

Ambasadori amerikan: Trump e paralajmëroi Xhinë që të mos e mbështesë Iranin

Italia drejt zgjedhjeve të 2027-ës, alarmi për përdorimin e IA-së në fushatën elektorale

14:26, 28/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Nga Alba Kepi

Përdorimi i inteligjencës artificiale në komunikimin politik po hap një debat të ri në Itali, ndërsa vendi i afrohet zgjedhjeve politike të vitit 2027. Në qendër të diskutimit është bërë një fotografi e manipuluar e deputetes së Forza Italia-s, Matilde Siracusano, e publikuar në rrjetet sociale nga Roberto Vannacci.

Rasti ka rikthyer vëmendjen te përdorimi i deepfake-ve në politikë, një teknologji që mund të përdoret për të ndryshuar fotografi, video apo regjistrime audio dhe për t'i paraqitur ato si materiale autentike.

Siracusano, politikane nga Messina dhe deputete e Forza Italia-s, është aktualisht nënsekretare e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

Ajo reagoi pas publikimit të fotografisë së manipuluar, duke paralajmëruar ndjekje ligjore.

Fotografia u publikua nga Roberto Vannacci, ish-gjeneral i ushtrisë italiane dhe eurodeputet, i cili u shkëput nga Lega dhe krijoi forcën e tij politike, Futuro Nazionale. Vannacci ka kundërshtuar përgjegjësinë për manipulimin e imazhit dhe ka deklaruar se fotografia ishte marrë nga një burim tjetër.

Publikimi ndodhi gjatë fushatës për zgjedhjet e pjesshme në Reggio Calabria, duke e bërë çështjen pjesë të drejtpërdrejtë të një gare elektorale. Pikërisht ky element ka rritur shqetësimin politik në Itali për mënyrën se si përmbajtjet e krijuara ose të ndryshuara me inteligjencë artificiale mund të përdoren në periudha zgjedhore.

Pas rastit, Alberto Barachini, nënsekretar i Presidencës së Këshillit të Ministrave dhe përgjegjës për informacionin dhe editorinë, propozoi një angazhim të përbashkët të forcave politike. Ideja e Forza Italia-s është që partitë të bien dakord të mos përdorin gjatë fushatave materiale të manipuluar me inteligjencë artificiale për të krijuar deklarata, vendime ose situata të rreme që u atribuohen

DW/A do ta ekstradojë Kroacia të dyshuarin për shpërthim?

Presioni i protestave, jep dorëheqjen presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç

Xi Jinping-Trumpit: Inteligjenca Artificiale duhet të mbetet nën kontrollin e njeriut

Të rinjtë në SHBA po pinë më pak alkool, por konsumi rritet te moshat mbi 50 vjeç

amendimet për të riguar deklaratat, reprimet ose shprehjet e fëmijëve që u kishin bërë kandidatëve.

Sipas kësaj qasjeje, partitë do të vendosnin një kufi politik për përdorimin mashtrues të teknologjisë, veçanërisht në rastet kur një fotografi, video ose regjistrim audio mund të bëjë që një zgjedhës të besojë si të vërtetë një material të fabrikuar.

Partia Demokratike kërkon që çështja të trajtohet edhe përmes legjislationit. Anna Ascani, deputete e PD-së dhe nënkrytare e Dhomës së Deputetëve, ka qenë ndër politikanet që kanë kërkuar rregulla specifike për përdorimin e inteligjencës artificiale në fushatat zgjedhore.

Ascani ishte promotore e projektligjit C. 2212, i paraqitur në Parlament në janar 2025, i cili synonte të ndërhynte në rregullat për fushatat elektorale dhe referendumet për të parandaluar përdorimin mashtrues të përmbajtjeve të krijuara ose të manipuluar me inteligjencë artificiale.

Propozimi u shqyrtua nga Dhoma e Deputetëve, por më 11 mars 2026 procedura përfundoi pa miratimin e tij. Dokumentet parlamentare tregojnë se gjatë shqyrtimit të projektit u miratuan amendamente që hoqën nenet e tij, duke bërë që nisma të mos kalonte më tej në atë formë.

Debat i rikthyer pas rastit Siracusano tregon se çështja e deepfake-ve nuk është e re për institucionet italiane. Ajo ka qenë tashmë pjesë e diskutimeve parlamentare, ndërsa tani është shfaqur në mënyrë konkrete brenda një fushate zgjedhore.

Në Itali ekzistojnë edhe rregulla të tjera që mund të aplikohen në raste të caktuara të përmbajtjeve të manipuluar, veçanërisht kur publikimi i tyre shkakton dëm ose cenon të drejta personale. Megjithatë, debati aktual lidhet me pyetjen nëse këto dispozita janë të mjaftueshme për realitetin e ri të krijuar nga intelijenca artificiale dhe rrjetet sociale.

Deepfake-t përbëjnë një problem të veçantë në periudhat elektorale sepse mund të krijohen dhe të shpërndahen shumë shpejt. Një fotografi e manipuluar mund të arrijë mijëra përdorues përpara se të verifikohet, ndërsa një video ose regjistrim audio i gjeneruar me IA mund t'i atribuohet një politikani një deklaratë që nuk e ka bërë kurrë.

Për këtë arsye, debati në Itali nuk lidhet vetëm me teknologjinë, por edhe me transparencën e informacionit politik. Një pjesë e rëndësishme e diskutimit është mënyra se si mund të dallohen materialet autentike nga ato të krijuara ose të ndryshuara artificialisht, sidomos në ditët e fundit të një fushate.

Rasti i Matilde Siracusanos ka shërbyer si një shembull konkret i kësaj sfide. Një fotografi e manipuluar, e publikuar në një periudhë zgjedhore, ka mjaftuar për të hapur një debat mes forcave politike mbi përgjegjësinë, transparencën dhe kufijtë e përdorimit të inteligjencës artificiale.

Ndërsa zgjedhjet e vitit 2027 afrohen, partitë italiane përballen me nevojën për të përcaktuar se si do të përdoret IA në komunikimin elektoral dhe çfarë masash do të ndërmerren ndaj përmbajtjeve që synojnë të paraqiten si reale, ndërsa janë të manipuluar.

Për momentin, në tryezë janë dy qasje: një marrëveshje politike mes partive për të shmangur përdorimin mashtrues të deepfake-ve dhe një kuadër ligjor më specifik. Debati pritet të vazhdojë ndërsa intelijenca artificiale po bëhet pjesë gjithnjë e më e rëndësishme e komunikimit politik italian.

© SYRI.net

Lexo edhe:



BE zgjat mandatet e misioneve civile në territoret palestineze



Bazat ushtarake të Britanië mund të jenë objektiva të aktorëve të mbështetur nga shteti



Iraku: Trupat amerikane janë tërhequr plotësisht

Gazetari i CNN përball Vuçiçin me të kaluarën e Serbisë: Kur Perëndimi mendon për ju, i kujtohen luftërat në Ballkan



Etna shpërthen/ Mbyllet aeroporti i Katanias, hiri vullkanik mbulon qiellin e Sicilisë



Zbulohet plani i diskutuar: Berlini planifikon uljen e emigrantëve të punës nga rajoni

TË NGJASHME



Akuzat për vjedhje/ Parlamenti hungarez i heq imunitetin kryeministrit Magyar



Hakmerret Izraeli, u heq akreditimin diplomatëve holandezë për shkak të ndalimit të importit



Përmbysset varka në Kanalin Anglez, 3 të vdekur në përpjekje për të shkuar në Britani



Francë/ E djathta ekstreme e Le Pen fiton 15 vende në Senat, mjaftueshëm për të formuar grupin për herë të parë



Ambasadori i SHBA në Pekin: Trump e pyeti Xi nëse Kina do të blinte armë amerikane



BE po shqyrton mundësitë se si t'u përgjigjet kërcënimeve hibride ruse



Aktivizimi i vullkanit Etna bllokoi aeroportin e Katantias për të tretën ditë radhazi

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MËDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.